

Z. Besim Gorr

VITI I VII.

— JANAR 1936 —

Nr. 1

NORMALISTI

Jo në dijën, por në vullnetin
e fortë qëndron
vlera e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshmeja "NORMALISTI,"
Shkolla Normale
Elbasan.

Shtypshkronja "SAIDE," Elbasan
1936

Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore
DEL NË FUND TË ÇDO MUAJI.

E botojnë nxënësit e Normales.

Editor : Harilla Kuçuli '37.
Sekretar : Hysejn Hashorva '37.
Arkëtar : Jovan Gjerga '37.

Ndihmësit

Polikron Niçe '38.
Panajot Foto '38.
Elami Nimani '39.

**Pajtimi: për gjashtë numra 1 Fr. ari
Nji numër kushton 1 Lekë.**

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Midis nesh.

Kur ishim duke hapur një fushatë për mbledhje ndihmash, për të ribotuar të përkohëshmen t'onë, një shok më tha: do të ngjallet përsëri "Normalisti"?

U mendova pak ç'përgjigje t'i jap dhe, mbassi m'erdhi vështirë, heshtja. Unë e dija të gjallë, kurse shoku e dinte të vdekur. Ai kishte arsyet e tija dhe unë të mijat. Se ç'e shtyti shokun t'a quajë të vdekur "Normalistin", dhe ribotimin e tij një "ngjallje", nuk e di. Sa për vehten t'ime, e dija të gjallë të përkohëshmen në zemër të Normalistëve, prandaj, ridukjen e saj nuk e konsideroja si fenomen.

Kaloi, një kohë e gjatë kështu në ftohtësirë. Një pjesë e madhe e nxënësve çqetësohesh për fatin e se përkohëshmes. Një grup prej tyre filloi të veprojë: më nj'anë duke thirur një mbledhje ku-u bisedua gjër e gjatë çështja e Normalistit! m'anë tjetër duke u-përpyetur për gjetjen e të hollave të nevojshme. Puna e këtij grupi pati sukses. Dhe "Normalisti", me vullnetin dhe përkrahjen e të gjithë nxënësve, sot ribotohet.

Duke filluar punën.

Bejmë një fillim pune dhe fillim shumë të vështirë, nga gjëndja në të cilën ndodhet "Normalisti", I mbytur në borxhe, pse? Se pajtimtarët nuk përmbushin detyrën e pagesës—thonë disa. Unë kujtoj se kjo është arsyeja e parë. Një gjë është e vërtetë: Shqiptarit nuk i ka ënda të paguajë dhe veçanërisht për punë... pa rëndësi.

Ndërsa marrim përsipër "Normalistin", nuk na pëlqen të bejmë pretime duke thenë se jemi të zot t'a nxjerrim në rregull. Nuk premtojmë se dalja e "Normalistit", nuk varet nga dëshira e jonë. Varet drejt për së drejti nga vullneti dhe përkrahja e gjith'atyre q'e quajnë të dobishme në mos të nevojshëm. Për këto arsye i lamë më nj'anë pretime.

Ndryshimet q'u bënë sivjet në organizimin e Normalistit janë me rëndësi! 1) Serioziteti në punë, duke mbajtur edhe shkretën më të vogël në rregull; 2) E drejta e kontrollimit, muaj për muaj, në veprimet e këshillit nga ana e përfaqësuesve të klasëve, për të përjashtuar, sa të jetë e mundur, çrregullimet dhe abuzimet; 3) ndryshime detyrim, që të gjithë, të përpiqemi për një t'arh-më të mirë të së përkohëshmes. Me këtë frymë të re që na ka pushtuar shpresojmë në kalimin e pengesave që na paraqiten.

O burrani, pra ...

Këtë thirje e drejtojmë: A) Të gjithë arësimtarëvet, normalistë ose jo, pa dallim shkollë, mbassi që të gjithë i drejtohen njëj qëllimi, që të gjithë janë përveshur njëj lufte: shdukjes s'errësirës dhe padijes; B) Kandidatëve mësuës dhe mësuëse që përgatiten për rrugën e lart-përmendur.

Të gjithë sa jemi të mundohemi t'a bëjmë "Normalistin" urën e kalimit midis nesh. T'a mbajmë organin t'onë të vetme ku do çfaqen, herë mbas here, mendime që do të na lehtësojnë aritjen e qëllimit. Le të shikojmë t'a përmirësojnë, sa të jetë e mundur, sepse ay është mburja e jonë. Të mundohemi t'a bëjmë sikurse e kanë dashur themelonjësit e tij: **një ndërtesë të madhe arsimore.**

Mbassi varet prej nesh, o burrani!

Harrilla Kuçuli

Detyra e mësonjësit Shqipëtar.

Të gjithë e dijmë shumë a pak se ç'farë detyrash ka mësonjësi, ç'farë barre merr përsipër dhe sa rëndësi ka vepra e 'tij për shoqëni e për shtet.

Por, në qoftë se mësonjësi në shtetet e tjerë ka për detyrë t'edukojë dhe të mësojë fëmijët e popullit, në Shqipëri ka një detyrë edhe më me rëndësi. Mësonjësi Shqipëtar nuk duhet të mjaftohet vetëm për edukatën dhe mësimin që do t'u jape fëmijvet mbrënda në shkollë. Puna e 'tij duhet të shtrihet edhe jashta murevet të shkollës; duhet të kujdeset për përmirësimin e gjëndjes së popullit dhe sidomos t'atij të krahinave.

Dihet, se populli i krahinave nuk rron ashtu si duhet. Me këte nuk dua të them se nuk vishet me rroba sport e me bor-salino, nuk banon në ndërtesa madhështore me 4-5 kate etj. Ktij i mungojnë disa gjëra elementare, por që janë më kryesoret si p. sh. pastërtija, rregulli në çdo punë etj.

Me qënë se në krahinat nuk ka kush t'udhëheqë popullin dhe t'i përmirësojë gjëndjen e 'tij, vetvetiu kjo punë i mbetet mësonjësit, i cili nuk duhet ta quajë si barrë por si detyrë të shënjtë.

Do të më thotë dikush se mësonjësin në shumë vënde as që e pyesin fare, sepse populli hiqet si shumë i ditur. Si mbas

mendimit t' im, kjo gjë rrjeth të shumtën e herës nga se mësonjësi nuk di se si të fitojë dashurinë dhe besimin e popullit, gjëra që kanë një rëndësi të madhe për suksesin e veprës së 'tij. Se si do t'i fitojë mësonjësi këto, nuk i përket kësaj theme, veç se po i fitoi një herë, puna e 'tij bëhet shumë e lehtë. Mësonjësi në fillim do të përpiqet që t' u rrënjosen mirë fëmijvet kuptimet e pastërtisë dhe të rregullit duke dhënë vetë ky shëmbellën e mirë për të dyja.

Kështu pak nga pak do të fillojnë fëmijët që të mos durojnë papastërtinë dhe pa rregullinë në shtëpi, në lagje e gjetkë. Këtë punë do ta plotësojë vepra e mësonjësit jashta shkollës.

Ky nuk do të lëjë as një rasë pa u folur katundarëvet mbi mungesat që kanë dhe mbi mënyrat e përmirësimit të tyre. Dihet, se ka një rëndësi të posaçme edhe mënyra e të treguarit të këtyre mungesave.

Mësonjësi mundet që të mbajë konferenca gjatë ditëve të pushimit ose në çdo rasë t' jetër që t' i paraqitet si p. sh. në ndonjë mbledhje të tyren etj.

Kur të shofin katundarët, se mësonjësi interesohet me të vërtetë për gjëndjen e 'tyre, atëhere dashurija dhe respekti kundrejt 'tij do të shtohen. Në këtë mënyrë mësonjësi bën diçka të dobishme për vëndin e 'tij. Eshhtë e ditur, se kjo punë nuk munt të bëhet për një kohë të shkurtër dhe prandaj mësonjësi nuk duhet të dëshpërohet, në qoftë se mbas një viti p. sh. nuk shef frutin e veprës së 'tij. Ky, duke qënë i pajisur me durim, që është virtyti më kryesor i 'tij, duhet ta vazhdojë punën pa u lodhur. Kështu mbas një periudhe prej 5 vjetësh p. sh. krahinat t' ona do të marrin një përmirësim, në mos më shumë, por deri më 50%. Me këtë rasë munt të thuhet diçka edhe për shkollat e natës, të cilat sot po hapen nëpër krahinë. Mësonjësi nuk duhet të bëjë këtë punë, d. m. th. mësimin e natës, sepse i urdhërohet prej ministrisë ose inspektorisë, por sepse është një punë e mirë, sepse duke e bërë këtë, i fal qorrit sytë, i hap popullit një orizont të ri.

Shifet pra, se mësonjësi Shqipëtar ka më shumë detyra se ai i shtetetevet të tjerë dhe prandal duhet të jetë krenar dhe të punojë më tepër se ai, se nuk rrit vetëm brezin e ri, por përmirëson dhe gjëndjen e popullit t' jetër.

(Fusha e Bardhë)

Rafti i libravet t' ona dhe përkthimet.

Shqiptari ka etje për kulturë. Asht i ûnshëm për libra. Na jemi në përparim e sipër. Në këtë kohë duhet të jetë kujdesi më i math i rritjes e i formimit të karakterit t' onë.

Sikurse zgjidhen ushqimet për fëmijët, ashtu lypset të zgjidhen mjetet për përparimin e njëj kombi.

Me thënë të drejtën rafti i libravet t' ona deri sot ka qenë mangut shumë. Nashti mbushet e plotsoliet dita-ditës. Por libra shqipe nuk kemi aqë, sa na duhen. Shkrimtarët t' onë kanë marrë një rrymë më tepër letrave. Librat shkencore e pedagogjike i kemi fort të paka në gjuhën amtare.

Nxânsit e shkollavet vuejnë (ose vuejshin!) për tekste.

Shumë herë detyrchen t' i shkruajnë me dorë detyrimet e tyne; kështu humbin një kohë, të cilën mund ta përdorin për studim.

Populli është tue pamë vetëm një faqe të kulturës: përgjithnisht atë letraren. Shumë vëtë marrin nepër gojë emna shkrimtarësh të mbëdhej në çdo lamë të dijës, por veprat e tyne nuk i kemi pamë as n'andërr. Prej atyne fort pak përfitojnë: vetëm ata që kuptojnë mirë një gjuhë të huëj.

Elementet, të cilët formojnë kulturën e njëj populli, lypset të kërkohen tek ata, që i kanë ose i kanë pasun. Këtë të drejtë nuk e luen gjâ. Shumë bukur. E na ç' ka po bâjmë? Po mbledhim kulturën. Po përkthejmë të gjithë. Dikush përkthen Aventurat e Arsen Lupenit me Sherlock Holms-in, një tjetër Pickertonin e ku ta dij unë... Rrugës ndëgjoheh zâni i fëmivët, të cilët bërtasin me disa fashikuj ndër duer.

E thashë se po përktheimë, që të mbledhim kulturën. Por gabova shumë. E vërteta është se duhem të fitojmë lekë, se sa për kulturë nuk na ha malli aqë fort. Le të rrojë dhe Zyra e Shtypit, mbassi nuk na e vë veshin se ç'ka marrim e përkthejmë...

Kështu rafti i libravet t' ona sot po qelbet fund e majë. Me përjashtim të disa librave, u-bâ për t' i vû xixën këtij rafti fund e krye...

Dihet se qëllimi i parë i çdo përkthimi është dobija edukative. (më falni se harrova: leku është kryet e punës të paktën ndër na).

Nji herë sa për tekstet shkollore, librat shkencore e pedagogjike është t'jetër çashtje. Kjo barrë i mbetet Ministris s' Arsimit, e cila lypset të ketë pranë vetiu disa njerës, që e dinë shqipen me rrëjë dhe një gjuhë mirë e bukur, e t'ia fillojnë punës. Herbarti, Comeniusi, Spenser, Pestalozzi, etj. Ç' janë gjithë këta? Për na janë emna të thatë e asgja t'jetër. Në gjithë kombet e përparuem i kanë dhënë një fuqi të madhe përkthimevet, por mos të kujtojmë si këtu. Atje është puna ndryshe. Në çdo gjuhë do t'i gjejsh të gjitha veprat më të zgjedhuna të shkrimtarvet të njoftun.

Sa për librat popullore gjithfarësh Zyra e Shtypit duhet të ketë një kontroll të mirë e të mos lënë që të futen në truclin e virgjën të mendjes s' onë gjithfarë plëhnash... Nuk kam ç' të bëj. Hajt pra, ta rrok një herë atë kalem të shkretë e të përkthej ndonji libër. Ç'farë libri? Ç' të jetë. Si do ta bëj? Me hamendje, si të ma nxajë kaploqja. Por le të ndalem një herë; ku shkoj? Kësaj i thonë: "kur s' ke punë, pse luen derën?"

E para e punës çdo njeri nuk mund të përkthejë, as nuk duhet të lihet i lirë. Ata, të cilët e ndiejnë vehten t' aftë, pse të mos lodhen e të përkthejnë libra, të cilat kanë vlerë morale e edukative për njerzën? Asht e vërtetë se kemi këso njerzish, por këta janë të rrallë. Të tjerët zënë e përkthejnë ose pse duen të fitojnë lekë, ose pse kërkojnë të duken nga të tjerët...

Gjithashtu fletoret e të përkohëshmet e ndryshme lypset të jenë gjithëhera të kujdesëshme në përkthime. Jo mbush e derth e baj e bjer kot e kot! E përsëris dhe këtë herë se Zyra e Shtypit nuk do të bënte keq sikur të ushtronte një mbikqyrje e kujdes më të math në këtë punë. Nuk është e mirë të mbledhim gjithfarë qelbësinash, të cilat gjetiu i gropojnë pa u dalë era, e t' i ruejmë si visare të çmueshëm...

Qukapiku

A është i nevojshëm vet-veprimi?

Janë shumë njerës, që, kur e kanë të ndarë e të caktuar punën, i vihen kësaj pa ngurim. Këtyre disa herë u pëlqen më mirë një punë e rëndë e e gjatë se sa një punë e lehtë, e e shkurtër, por që kërkon pak gjykim dhe nisëtiavë.

Të pakë janë p. sh. nxënësit, që e ndajnë punën vetë e kryejnë këtë me kohë. Shumica e këtyre e kryejnë detyrën

vetëm atëhere kur shtërngohen, kur detyrohen, dhe, në qoftë se kanë një varg detyrash, i lenë këto të grumbullohen për në kohën e fundit për dëm të detyrave të tjera që s' presin.— Të tillë njerës kanë nevojë që t'u detyrohet puna dhe t u caktohet me rregulla të kthjellta, dhe, në qoftë se i lë të vendosin vetë ata perdorimin e kohës, te ndajnë punën d. m. th. të vetë-veprojnë, u bje më qafë, i mundon: ata në këte rast ndodhen në turbullim, nuk dinë nga t'ia fillojnë, vinë rrotull, nuk dinë ç'të bejnë.

Këta u ngjajnë maqinave: janë sëhatë që punojnë kur kurdisen jo vetë, por prej të tjerëve. Janë njerës me vullnet të sëmurë, u mungon kurajua, nisiaiva.

Këtë mungesë nisiaive e shohim më tepër kur u shtrohem disa zakoneve qesharake, traditave dhe sidomos përdorimit të përditshëm. Duhet pra domosdo kurajo, që të përbuzim dhe të mos vemë pas këtyre zakoneve trashamane. Eshtë një skllavëri për inteligjentin t'u shtrohet traditave të paarsyeshme dhe zakoneve të përditshme. Njeriu nuk e ndjen vehten të lirë në qoftë se nuk guxon të përbuzë këto zakone që janë me të vërtetë të dëmshëme.

Eshtë shumë lehtë të vesh pas të tjerëve, të lidhesh pas zakonit. d. m. th. të bësh pa ndryshim atë që bëjnë të gjithë; mirëpo të veprosht kështu është të vesh të tanishmen dhe t'ardhmen nën të shkuarën, të vesh vehten nën një shërbim që ka ndaluarë dhe vazhdon të pengojë përparimin.

Kështu është janë fjalët e disave kur i pyet për se e bëjnë këtë ose atë punë. S'dinë të thonë më tepër, punojnë mekanikisht, s'pyesin përse? dhe s'mendohen në qoftë se munt ta bejnë më mirë. Ata që kënaqen me kaq dhe s'përpiqen të harxhojnë pak mënd, të nxjerrin një gjë të tyre të re, qofshin dhe të rinj nga mosha janë **pleq**, s'rrojnë në të tashmen rrojnë në të shkuarën.

Sado e vogël të jetë puna, por e bërë prej nesh vet-vetiu ka vlerë të madhe se na përgatit për në t'ardhmen; dhe arthmja (si domos ajo e jona) ka nevojë për nisiaivë, për vet-veprim.

Të kuptohemi më mirë: Sot jam nxënës dhe punën m'a detyrojnë prandaj e kryej; të tjerë më udhëheqin dhe më caktojnë detyrat (superiorët e mi); nesër, kur të dal në jetën prak-

tike. cilin do të kem pranë që të më këshillonjë? Puna do ta dojë që unë të mendoj, të vendos dhe të veproj vetë. Por në qoftë se unë nuk jam mësuar të vet veproj, të kem nisativë në punë atëhere do të ngec në një gjendje mjaft të vëshurë.

Prandaj shokë, në qoftë se duam të jemi të rinj, të jemi vetë e të përparojmë, duhet të shkundemi nga disa pengesa prapanike, të jemi nisiatorë në punë t'ecim me mend e me qëllim (jo mekanikisht) të synojmë kurdoherë në punë të reja, të tregojmë dishka t'enën. Të mos kënaqemi me këtë që kemi (me pak). Së pari me punë të vogla dyke rinxjerrë "Normalistin,, të çfaqemi me atë të përbuzim heshtjen dhe t'i japim një nxitje lëvizjes s'onë mendore duke pasur kurdoherë parasysh divizion t'onë: **Mirë e më mirë e lart e më lart.**

Tajar Reovica

Provë mësimi

Dhanun në klasën e II t' Ushtrimores për maturë.

Kandidatja : Liria Xhufka

Landa : Djathtësi

Thema : Ilustracion " Bleta ,,
(Nxjerrun nga mësimi i jetës " Bleta ,,)

Pikat e veprimit

(Dispozicion)

- 1 — Përfllitet shkurt mbi çka është fol n' orët e kalume.
a) Bleta, b) Zgjui dhe trajta e përjashtme.
- 2 — Përfllitet figura të nxitur prej mës.
- 3 — Vizatohet figura prej 2-3 nxansvet në dërrasë të zezë.
- 4 — Vizatohet mâ e mira prej të gjithvet.
- 5 — Krahasohen.

Hyrja : Për me u bâmë koncetracioni i landës së mësimi, lidhet mësimi i ri (Ilustracione " Bleta ,,) me mësimet e ma parshëme.

Mbassi në mësimet e mâ parshëme është fol mbi bletën gjan e gjatë, mës. bân një hyrje të shkurtën e të vovitshme me të cilën mund t'i zgjoj fëmivët parafytyrimet e t'i báj gadi me e kapë edhe me ja përvehtësue gjan e re. Mënyrat e hyrjes

janë të shumta; ndën këte bân edhe këjo : mës. mbi çka folëm der tash ?
 A dini të më më thoni se ku banon bleta ?
 A e bân vet zgjun bleta, a po ja bân tjetër kush ?
 Ju keni pa zgju, pra kujt i ngjan zgjui nga forma e jashtme ?
 Po ku e vejn zgjun njerzit ?
 Njerzit e vejn shumë herë në pemë po shumë herë e vejnë sipër një druni afër një peme. Pra sikur të dum të vizatojmë zgjun e bletës afër kujt duhet ta vizatojmë ? Pra çka duhet të vizatojmë herën e parë ? si të kemi vizatu pemën, çka do të vizatojmë tjetër ? mbi çka qëndron zgjui ?

Paraqitja — Si vizatimi një ashtu edhe ilustracioni janë mësimë ku kërkohet fantazi, lehen për këte arësye fëmijë të lirë të vetveprojnë në këte mënyrë : theriten dy a tri fëmijë në dërrasë të zezë të vizatojnë mbi çka u-folë në hyrje, ndërsa të tjerët nënë udhëheqjen e mësuesit ndjekin shokët e tyre. Si të jenë mbarue vizatimet, përfiliten dhe më mira plotësohet dhe merret si shembull — Në takt të mësuesit, nxirren radhojt dhe gjithë secili fillon të vizatoj të vetën mbas shembullës së dërrasës zezë.

Mbassi t' a ken mbaru vizatimin, mirren 4-5 radhoj dhe krahasohen prej fëmijet vetë nën udhëheqjen e mës., me qëllim që fëmija t' edukohet me dallu të mirën prej të keqes, të bukurën prej së shëmtumes, të pastrën prej së ndytës.

Tabella

Një pemë pranë së cilës ndodhet zgjoi i bletavet,

Fragmente nga romanci "Pse !!.."

i Sterjo Spasse-s.

Mos harro se në nderin e kemi më të shtrenjtë se bijt, se mallin e se vet-vehten.

. . . Në kohën e drekës babaj më thirri në dhomën e vogël të shtëpisë. Hyra mbrenda me rend : Babaj ishte mbështetur mbi një nënkresë dhe me qetësi thëthinte duhanin e pipës së trashë, kurse tymi porsi shtresë reje ngrihej në hapësirën e vogël të dhomës. Pranë 'tij qëndronte nëna pak e menduar. Unë, pa treguar ndonjë shenjë mërziqeje, zura vënd mbi fron afër tryezës.

Katundarët t' onë nuk e kanë zakon t' i ngatërojnë e t' i zbukurojnë bisedat me figura si të qytetëruarit. Ata janë të

Mirpo ai vënt i shkretë e i varfër nuk kishte rrugë, nuk kishte të përpjekur as fare me ndonjë qytet; populli, sikurse thamë dergiej në një përtësë dhe kotësi; fjalët e këshillat e Oberlin-it humbin si një zë në shkretëtirë; por vullneti i tij nuk ia humbi kurrë shpresën. Ai mori vetë kazmën në dorë dhe filloi të çelë rrugën e parë; me këtë mënyrë populli u-turpërua dhe i u përvesh punës duke i rënë pas udhëheqësit të tij.

Në një kohë të shkurtër u-çel në rrugët, filluan marrëdhëniet me qytetet e tjerë; populli zuri të nxjerrë produkte të mjafta, patate e pemë, të cilat i ndërronte me të tjera të nevojëshme.

Ja se ç' bën vullneti i një mësuesi idealist! Oberlin-i, një grusht njeri, tërhoqi në rrugën e shpëtimit një popull gjysmë t' egër, sikurse ishte atëhere popullit i Ban de la Roche-it; ai vdiq duke parë me syt' e vet vertetimin e idealit të tij. Populli i Ban de la Roche-it e varrosi me nderime të mëdha dhe e vajtoi për jetë. Pra një mësues i tillë nuk' vdes kurrë, shpirti i tij është i gjallë; shëmbëlla e tij është një pasqyrë për të tjerët.

Këtë shëmbëll duhet të ndjekim edhe ne, t'i zbatojmë njohnitë t' ona praktike në jetën shoqërore, bujqësore e blektore. T' i shtiemë dashurinë e punës popullit t' onë e t' ia rrëfejme burimet e rroitjes së tij, qysh munt të shpëtojë nga varfëria e nga mjerimet q' e sundojnë. Cilitdo prej nesh, që i ka takuar ose munt t' i takojë t' ushtrojë mjeshtërinë e tij në malësitë ose në fushat t' ona, i duhet të punojë duke pasur për shëmbëll Oberlin-in.

Vetëm duke punuar me një ideal të tillë, munt ta shpëtojmë popullin t' onë nga moçalet, që galim ka mbetur prej shumë shekujsh; vetëm me një ideal të tillë, munt t' i sigurojmë Atdheut t' onë të dashur një t' arthme të lumtur, të cilën, në mos ne, të tjerët që do të vijnë mbas nesh, le ta gëzojnë.

F. I. Babani '29,

Zhvillimi i muzikës në shekujt XVIII e XIX dhe përfaqësuesit e 'saj më të parë.

Dihet se muzika ka pasë edhe kjo drejtimet e veta shkallë, shkallë e ka mundë me anë të përparimit të 'saj të ushtronjë influencën më të madhe në kulturën njerëzore.

Sidomos shekujt e XVIII e XIX i kanë kushtue këtij arti dher komponistësh të mëdhej, të cilët kanë qenë e janë etnit e muzikës e riformuesit e 'saj. Këta janë ata qi kanë derdhun djersë, a si me thanë, janë shkrimë, për f'ia mbërrijtan idealit të pashterun të këtij arti. Bota e gjithë sot mburret me veprat e **Beethoven-it**, **Mozart-it** e të **Wagner-it**, tre yjt e shkëlqyshëm, qi kanë ndriçuem udhën gjatë këtij deti të paanshëm edhe për pasardhësit e tyne. **Beethoven-i** është tipi i një njeriu plot me hidhërime, dëshpërime e vuejtje. **Wagner-i** mirret si tipi i një njeriu të tillë, qi gjithmonë zemërohet, kërcënohet e kanoset kundër të tjerëve. Përkundrazi **Mozart-i** qan me lot vuejtjet, këndon dashurin e njeriut në këte botë.

Në vitin 1685-1750 dallojmë në Gjermani **J. S. Bach** prej familjes **Bach**. Në veprat e tij çfaqet një harmoni e rrallë e ka qenë çmuë mjaft në kohën e vet.

Po në këtë kohë në Gjermani çquën një fytyrë tjetër komponisti e ky është **Cristophe Willibald Gluck**. (1714-1787) Asht auktori i shumë operave si : " **Orphée** „ , " **Alceste** „ , " **Iphigenie en Aulide** „ . Ky riformoi operat e veç kësaj bëni edhe një dramë. Çquhet për stilin e 'tij të hollë e artistik.

Por një ndër më popullorët komponistë të kësaj kohe në Austri ka qenë **F. J. Haydn** i 1732-1809, i cili, me gjithë qi hyn në rrymën e kohës moderne, por prapë thellohet më fort në kohën e shkuëme. Me meritim është quëjtun themeluesi i muzikës instrumentale Gjermane. Asht krijuësi i kuartetes e i simfonis. Veprat e tij më të përmenduna janë: " **La création** „ , " **Les saisons** „ . Ka një stil elegant, sidomos në menuetat, ka një stil të kthjellët e melankolik në simfonit.

Po një nga më të përmendunit komponentë të shekullit XVIII ka qenë **Wolfgang Amedeo Mozart-i**. Leu në **Salzburg** më 1756.

Talenti e virtuozyteti i math i këtij djali u-çquë qysh në vogëli. Ç kur ishte ende tre vjetësh përpara një publikut luëti piano, tue pasë suksesin më të math. Veprat e tij plot me thellësi e melankoli, çquëjnë sot si nga më të mirat. Në këto artisti të shtie në mallëngjim të pashoq e të prek atje ku duhet, të prek si me thënë telat më të thella të shpirtit. Nga veprat e tija po përmendim: “**Titus**”, “**Idomeneus**”, “**Figaros Hochzeit**”, (dasëma e figaros), e “**Don Juan**”. Por mbi të gjitha rradhitet “**Zauberflöte**”, (fyelli magjik). Sikurse kuptohet edhe nga emni i vet, kjo veprë është me të vërtetë e rrallë, këtu artisti qan me lot dëshpërimin e vuetjet e njeriut. Por fati i tij e dënoi të vdesi prej sëmundjes së pashërueshme, të tuberkulozit më 1791 në **Vjenë**.

Nga fundi i këtij shekulli çquëjnë edhe të tjerë komponistë të përmendun si **Händel i**, **Spontin i**, **Cherubin i** e të tjerë.

Më von del në shesh një yll i shkëlqyeshëm e i hyjnueshëm. q i çuditë gjithë botën e q i dha muzikës një drejtim fare të ndryshëm. Ky është **Ludvig van Beethoven-i**, q i leu në **Bonn** më 1770. Mund të themi se ky është një ndër komponentët më të mëdhenj, q ka pamë bota deri më sot. Asht i vetmi q çquhet me veprat e tija. Këto diku qajnë e diku qeshin, fillojnë me një butësi e qetësi prej vorri, por më von vijaë tue mbaruem me kunorë triumfi. Këtu artisti ka çfaqun gjithë ndjenjat e tija të thella, zemrën e tij plot vuëjtje e dëshpërimë.

Asht për t'u-çuditun me këtë virtuozy të naltë. Kur do të kompozonte ndonji copë muzikore, pëlqente të qëndrojë në një vetni ose më ndonji pyll, ku zhurma e fishkëllima e lisave, bubullimat e shkrepimat e qiellit e inspironin në të kompozuemit. Edhe në veprat e tija çfaqen kudo po këto fenomene të natyrës. Ky është auktori i sonatevet, i kuartetevet, operave e simfonive. E vetmja operë e tij është “**Fidelio**”, veprë me një thellësi ndjenjash e me fuqi ekspresive të pashoqe. Ndër nantë simfonit e tija e vetmja, q çquhet e çmohet me të vërtetë si një kryeveprë e rrallë, është e fundit, (e nanta), një nga më të mrekullueshmet vepra, q kanë dalë nga dora e njeriut e q mirret sot si bazë për të gjitha drejtimet muzikore. Pastaj vijnë “**Eroica**”, edhe e pesta e shkrueme në **E- moll**.

Po fati i tij e dënoi këtë gjeni t' artit muzikuer e nuk mund

të shijojë veprat e rralla të 'tija.

Fundi i jetës së 'tij është për t' u-qamë me lot, mbassi në moshën 30 vjetësh u-shurdhue e kështu hoq dorë prej profesionit me aq vlerë për 'të, u-nda prej këtij, sikurse ndahet një njeri nga gjini i familjes së vet, tue i lanë " l'amtumir " , kësaj jete. Gjithë jeta e 'tij ka qenë plot brenga edhe nuk shijoi as një minutë fatbardhësi. Gjajja më e mjerueshme për të (si dhe për çdo artist) ishte, qi talenti i 'tij nuk çmohej e këte hidhërim e pikëllim e pati gjer në minutën e fundit sikurse shifet më poshtë.

Nji herë **Beethoven-i** u-thirr prej të nipit të 'tij, qi kishte ranë ngusht, të nisësh sa më parë për Vjenë.

Për të kursyem të hollat' nji pjesë të rrugës e kaloi në kambë. Por atë mbramje u-shtrënguë të flejë në shtëpin e nji katundari, i cili kishte tre djem, nji gocë edhe të shoqen e vet.

Mbas kohës së darkës djemt, të urdhnuem prej babës së tyne, muërrnë veglat muzikore e filluën me luejtë nji kompozitë, pas së cilës ishin dhanë me gjithë shpirt. **Beethoven i** kishte drejtue syt ke ata me nji të pame mëshiruëse e dukesh i ranë thellë në mendime. Po qante i mjeri fatin e vet, qi nuk mirrte pjesë n' atë kohë gëzimi. Pjesa u mbarue së luëjtuni e ne fytyrat e tyne shifesh shënja e mbrësës së thellë, që u kishte lanë ajo pjesë.

Beethoven-i filloi të shkojë nëpër mend se ajo pjesë do t' ishte nji prej kompozisjoneve të mjeshtërve të mbaruem.

" Ju lutem — u tha — më falni te shof se cili është komponisti i asaj cope, mbassi për fat të keq jam i shurdhët e s' mund të marr pjesë në gëzimin t'uëj., Me të marrmen në dorë këte, syt e tij u-errësuen dhe nji rë e zezë mbuloi trupin e 'tij; letra i ra prej duërvet e me nji herë i u-shpërthyen lot të thellë dëshpërimi. Gjithë sa u ndodhën aty ngelën të shtangët më kambë; me nji fytyrë plot frikë, tristim e habi e me gojë hapët po prisnin përfundimin. Pjesa e luëjtme prej 'tyne ishte simfonia në A-moll, qi kishte dalë nga mendja krijuëse e 'tija, ishte vepra e atij qi gjindesh ndërmet tyne, gjá për të cilën familja nuk kishte dijë. **Beethoven-i** atë minutë, i mbushun në lot, nuk mundi të fliste; pas pak lëshoi nji të fshame nga thellësia e shpirtit, sikur kërkonte të shfrynte kundër fatit të lik të 'tij u tha: " Unë jam **Beethoven-i** ". S ka pendë shkrimtari, qi mund të përshkruëjë mallëngjimin e math, qi i pushtoi të gjithë; derdhën lot hidhërimi edhe me nji herë i ranë

mësuar të flasin lakonikisht dhe në mënyrë detyronjëse.

— Ti e din, bir, se sa na ngatërrove me punën e fejesës. — e filloj babaj bisedën. — Së pari mua ma nxive faqen e bardhë, që kisha ndër kuvende, edhe familjes i vure një njollë të pa-shuar. A më kupton? Tani ti duhet të na zbardhish për së dyti faqen e nxime edhe t'ia shuash njollën familjes. Duhet pra të të fejojmë me Aferditën.

— Ju lutem, baba, mos më mirni në qafë, se jam i vogël dhe se s'dua të fejohem që tani — i thashë.

— Jo, jo! Zaver të jem, ja të mos jem më! — filloi të nxehet babaj. — Ti, një njeri me pesë shkronja, nuk mund të më thuash se të marrim në qafë. Ne që nuk të muarmë në qafë, kur të dërguam në shkollë, po ne nuk të marrim në qafë tani me fejesë. Ne duam të mirën t'ënde, . . . lumtërinë t'ënde e jo gjë t'jetër. Por ti nuk na kupton: kujton se duam të të varim. Mos harro se Zaverit nuk i është bërë fjala kurrë dy, as nuk duhet t'i bëhet. Unë, atë që them, nuk e marr prapë, e ti, ti si bir, do të më dëgjosh me doemos.

— Nuk them se nuk ju dëgjonj, por jam i vogël. — i thashë për së dyti.

— Ato fjalë thua-ja Kuku Maros e jo mua! A nuk i martojmë ne djemtë në moshën 16-18 vjeç? A nuk po e sheh ti, se shokët e tu janë bërë atër? A nuk e din ti se je 22-23 vjeç? E . . . burrë, burrë më! Nuk do të martojmë sa gjyshin t'ënd, se atëhere të fton vdekja. Tani është koha, . . . tani duhet të martohesh. A po nuk e don Aferditën. . . . a po nuk don katundare? Hej, hej, bir, mos harro se ne këtu nderin e kemi më të shtrenjtë se bijt, se mallin e se vet-vehten, prandaj gjer sa të jem i gjallë, unë nuk kam për të vënë në vatrën t'ime një leshra-prerë, . . . një kurvë edhe sikur të bëhet hi shtëpija e ime! Mendo-e mirë, në qoftë se e ke vendosur. Po të them: ja të jesh bir i em, ja të mos jesh! Pa fundi i fundit në drej me gjithë fitimin t'ënd. Për pak kam për t'i mbyllur sytë dhe hieja e ime dhe e nënës t'ënde le të të mundojë gjithë jetën! . . .

Sytë filluan t'i guxëllojnë, fytyra t'i skuqet, trupi t'i dridhet edhe flokët t'i ngrihen përprjetë. Ishte zemëruar aq shumë, sa i shpëtoi nga goja edhe nëma. E mbushi për së dyti pipën me duhan edhe u-mbështet më mirë te nënëkresja. U-mendua

një copë herë si i penduar për fjalët e ashpëra, që tha, u-koll disa herë e pastaj vijoi :

— Interesi i yt, bir, na shtyn, që të të martojmë me katundare. Një gjoks-hapur don shpenzime, . . . don salltanete e veshje mëndafshi. Ajo nuk do të pranojë kursesi për të jetuar bashkë me ne : Ajo ka për të dashur që nëna e jote të bëhet sherbëtorja e 'saj. A më kupton ? Porsa të martohesh me një të tillë, dhe ja u-ndave nga ne : nuk do të na përfillish fare; nuk do të na quash më prindër. Porse ti e din se ne duam nuse, nuse të tillë, që të na rijë gjithënjë në këmbë; duam nuse jo për pillime, por për punë, . . . për nder. Pa i thënë unë, ajo të sjellë zjarrin për të ndezur cingaren; pa i thënë unë, ajo të m' i lajë këmbët, të më mbulojë natën mirë; të m' i presi e të m' i përcjellij me fisnikëri miqtë, etj., etj. E këtë vetëm një katundare, një si Afërdita, mund t' i kryejë, por kurrë një leshraprerë.

— Nuk thashë ndonjë herë, baba, se dua të martohem me ndonjë qytetare. — i thashë për së treti pak me të ndruajtur.

— E po atëhere, . . . atëhere pra pse bën naze, pse nuk na jep fjalën për fejesë ? Ne duam me gjithë zemër të të fejojme, kurse ti po na kundërshton. Ti nuk duhet të bëhesh shkaktar; i prishjes së nderit familjar; ti nuk duhet të pranosh kursesi, që të bëhesh gazi i botës ! A e mban mënd ç' thoshnin katundarët, kur të dërgova në shkollë ? “ Zaver, mos e dërgo Gjonin në shkollë, se pastaj nuk do të jetë më për ty. Ka për të të lënë dhe të mirën kurrë nuk do t' ia shohish. ” — Kështu më thoshnin, mirpo nuk i dëgjova, por bëra atë që më preu koka. Tani mendo me mirë : nuk dua të dalin fjalët e botës. Kemi qënë nga familjet më të para të katundit, po ashtu duhet edhe të jemi. Kurdoherë dua që fjala e ime të rëndojë në katund ! A more vesh ? Hajde tani si burrat jep-na fjalën e nderit, . . . mos na mundo më. Sot Naumi pret fjalën e fundit e nesër duhet të bëhet fejesa. Hajde fol, Gjon, fol dyke prerë. — dhe heshti.

Pastaj nëna filloi të lutet dyke më përqaftuar e dyke më puthur me lote në sy.

— Jep-na fjalën, bir, jep-na, se me Afërditën ke për të qënë i lumtur. Ajo mund të jetojë si të gjejë edhe në katund, edhe në qytet, kurse një qytetare don vetëm të rrijë në qytet. Mendo pak t' arthmen : në qoftë se të ngjan ndonjë ngatëresë

në punë, mund të këthehesh në katund i qetë pranë prindërvet e pranë vëllezërvet; por po ta kesh nusen qytetare, atëhere do të jesh i detyruar të rish e të shpenzosh kot në katund. Një katundare, bir, është mësuar me bukë e pa bukë, por një qytetare jo! — Këto e të tjera më thoshte nëna.

U-turbullova shumë përpara fjalëve t'ashpëra të babës edhe u-mallëngjeva përpara fjalëve të nënës. Të dy flisnin për lumtërinë t'ime për t'arthmen t'ime! Të dy lumtërinë t'ime e shihnin në krahët e Afërditës. U-gjinda ngushtë pra: ja duhet të jepnja fjalën e nderit, ja duhet të çkatërronja gjithë atë lumtëri të familjes. Duhej të zgjidhnja njerën nga të dyja, por duhej një vendim i shpejtë: Pika djerse filluan të shkojnë nëpër trup, edhe mendimet e turbullta çponin trunin t'em. As një herë në jetën t'ime s'jam turbulluar aqë shumë: Të fejohe me Afërditën a të mos fejohe me? Të jap fjalën e nderit a të mos e jap? Hithnja sytë mbi gravatën e Polës që e kisha lidhur në qafë, e . . . atëhere më bëhej sikur dëgjonja një zë: "**Gjon mos harro Polën, se ajo të don, . . . të dashuron!**" Por më së fundi, i zbetë si përpara gjyqit, mora vendimin e famëshëm: kam për t'u-fejuar për hir të prindërvet, pa le të dalë si të dojë! — thashë me vehte dhe dhashë fjalën e nderit.

Atëhere një gëzim i papërshkruar pushtoi prindërit: nëna m'u-hodh në qafë, më përqafoi dhe më uroi për fejesën; kurse babaj ndejti këmbë-kryq, lëshoi pipën, përdrodhi mustaqet me gëzim dhe mori frymë lirisht edhe tha:

— **Tani më s'ka njeri si unë!**

Po n'atë kohë si vetëtimë u-përhap lajmi i fejesës në familje edhe të gjithë rendën të më urojnë. Motrat më përqafulan edhe të tjerët më shtrënguan dorën. Unë rinja si i mpirë, vetëm se çfaqnja një të qeshur dy-faqesh. Nuk durova më atë ngjarje, që më dukej si gjë për të qeshur, prandaj vura kapellën në kokë edhe dola i vetëm jashtë për të marrë pak ajr të pastër edhe për t'i qetësuar nervat prej bisedës ball për ball që kisha bërë me babanë.

Ecnja nëpër rrugën e Pod-buçelit, buzës së liqenit, me kokë të ulur dhe shumë i menduar. Mendonja vendimin, . . . fejesën t'ime, kurse atje te lëmenjtë bota katundare po dëfrehej, . . . po kremtonte Pashkët.

Arësye nuk më hynin në punë përpara fjalës së dhënë.

Ngula këmbë për katër-pesë vjet, por më së fundi zakoni i vënd-
lindjes doli më i fortë: fitoi, . . . por fitoi me detyrim, me
forcë! Rashë edhe unë theror i zakonit! As dituria, as mosha
e re, as . . . gjë t'jetër nuk vlekën më përpara kanunit të
vënd-lindjes: ai është i fortë, ka rënja të forta, të cilat as një
ligj me forcë nuk po i shkul dot: u-tha e . . . u-bë!

U-ndala në fund të rrugës, afër rërës, dhe ndejta mbi një
gur busë-liqenit. Dëshë të dëfrehesha pak dyke shijuar pamjet
romantike edhe dyke hedhur zaje mbrenda në ujë, por jo, jo!
Zemra më ishte e plagosur! Zëri i largët i Polës tani më mun-
donte fort, edhe, kur e shihnja gravatën e 'saj të vërur në qafën
t'ime, atëhere zëri më kthjellohej. Nuk më thoshte më: "Gjon,
mos harro Polën, se ajo të don, të dashuron!"; por më ngjante
sikur po ndigjonja këthjellët zërin e ëmbël dhe mallëngjëjës të
Polës:

— Gjon, pse më tradhëtove? Pse u-bëre aqë i pamë-shi-
rëshëm? Pse nuk pranove dorën t'ime? Pse u-bëre vrasësi i
lumtërisë s'ime? Pse mohon dashurinë t'ime? Fol pse, de? —
Dhe pse-të e Polës nuk mbaronin. Më çdo çap më tingëllonte
në vesh një psë e 'saj

U-ngrita nga vëndi për të shëtitur përsëri, por zëri i Polës
nuk po më ndahej, dhe sa herë që hidhnja sytë mbi dhuratën
e 'saj, zëri këthjellohej. Më ngjante sikur më fliste gravata vetë:
U-autosugestionova shumë:

— Pse mohove dhuratën t'ime? Pse mohove lulet e Vitit
të Ri dhe ato të Pranverës? Pse mohove dashurinë t'ime?
Pse u-bëre vrasësi i em? . . . — Ja, gjithënjë psë, vetëm
psë! Gjaku më hipi në kokë; gravata e Polës më mundonte
keq. Më ngjante sikur po më fliste ajo më ashpër dhe sikur një
faj i rëndë më rrotullohej rreth zemrës s'ime! Humba pra
durimin dhe sikur kam dashur t'i përgjigjesha zërit të dhuratës
dhe fait, që më rëndonte në zemër, thirra si i prishur mënj:

— Pse dëshë, pra!! . . . — Edhe me zemrim e me
forcë e hoqa gravatën nga qafa, e bëra copë-copë atje në buzë
të liqenit. Pastaj ika në shtëpi, por ika me vrull sikur po më
ndiqnin pas leckat e gravatës së Polës, që i lashë të çpërndarë
në mes të rrugës. — Dhuratë e çuditëshme, gravatë e magnë-
tizuar, . . . e magjepsur! — thashë me vehte.

Të bashkëpunojmë ke 'Normalisti,, për hirë të detyrës qi na është ngarkue.

Mbas një ndërprerje qi iu bë rivistës "Normalisti,, për disa kohë, sot shifet të dali prap, për me plotsue qëllimin e nxënësvet qi e botojnë, i cili nuk është t'jetër, veç me i shërbye Arsimit Kombtar dhe me çue nalt emnin e shkollës ku ata mësojnë.

I përgëzoj këta nxënës, shokët e mij t'ardhëshëm, dhe thërres Z. Z. Mësueset e Mësuesët, qi të mundohen e të gjejnë deri diku, përmirësimin e kësaj së përkohëshmes, qi është deri më sot e vetmja fushë për shtjellimin e themave pedagogjike dhe një shtëpi e mirë për mbledhjen e familjes arsimtare, prej së cilës ka varë shpresën e 'tij Kombi i Ynë.

Për ndërprerjen qi i është bë shpesh herë kësaj riviste, si, fajtor duhet të kërkohet pajtimtarët e ata, qi, tue pasë një zotsi, nuk marrin mundimin me shkruë e me shtjellue subjekte, qi i kanë hije një së përkohëshmes, si "Normalisti,, i ynë.

Si në çdo t'jetër, kështu edhe për këtë organ, vlen qi pajtimtarët e 'sajë, arsimtar, të bashkojnë zemrat e 'tyne, t'apin çerëkun e fundit të lekut e të humbin edhe pesë të parat e orës për një përkthim a hartim, qi i ka hije një së përmuejshmes si kjo, mbassi drejtuesit e 'saj, shpesh herë, nuk e kanë edhe kohën e duhur me hartue vetë themat e ndryshme, tue mos dashë me e mbushë vetëm me planë mësimi, për të cilën kanë shumë të drejtë se at'herë mbrendia e rivistës bëhet monotone.

E kam thënë, pra, dhe e themë se fai është vetëm tek në, se vetëm prej nesh duhet pritun lulzimi i "Normalisti-t,, Mësuesi dhe mësuesja nuk duhet të kursehen për 10-15 lekët e vitit dhe s'duhet qi, edhe pagimin e shtypshkronjës, t'ua lënë po këtyne nxënësvet, të cilët, të shtërnguem, marrin e organizojnë shfaqje teatrale e koncerte muzikore, për me mbledhë një dorë pare e me ia mbyllë gojën borxhliut qi u kërkon Kaqë më tepër, ata nuk duhet të kursejnë mundin, për me hartisë një themë çfare-do dhe me ia çue drejtimin për botim.

Por fatkeqësisht, as e para dhe as e dyta nuk ngjet. "Normalisti,, në shumë vende e në shumë durr, merret me përbuzje dhe nuk gjen as më të voglën përkrahje!

Shumë shokë, me vjet të mjafta shërbimi, e kanë për turp më duket me dërgue shkrime, se kujtojnë sikur u thonë bota:

“Po bashëpunon me nxânësin e vet!”, Por edhe me e këndue, këtyne iu-ngjan. sikur po u thotë kush: “Po këndon shkrimin e atij qi vetë e ka mësue:”, Çuditëm se si ky në kët rast nuk e ka për nder fjalën qi mund t’i thohet, bile dhe të krenohet se nxânësi, i dalun nga duerët e ’tij, arriti sa të shkruiej të zgjedhi thema të ndryshme!

Por edhe shumë Normalistë, të dalun prej kohe dhe qi e kanë fitue praktikën e duhun, e këthejnë kokën me nj’anë, thue sikur duen me u kallzue shokve të ’tyne më të vegjël, se ata janë mjeshtrit e mësuesis e se vetëm ata e kanë praktikimin e zotnimit e ’sajë.

Këtu nuk due me iu-drejtue gjithkujt, por vetëm atyneve qi janë të zott me shtjellue subjekte pedagogjike e me bā përkthime të ndryshme.

Në këtë të pëkohëshme, të vetme deri më sot, cilido e çfardo qoftë kategorija qi ia zë si armsitar mund t’api ndihmën materjale sa ia lëshon zembra dhe mund të shkruiej mbi çdo send të dijës, në qoftë se mendon se edhe në kët mënyrë i shërben arsimit dhe se i udhëheq e i nxit nxânësit e Normales, qi dikur u ka mësue “**abecen**”, dhe lëshue dëftesën e liritit nga shkolla fillore.

Nuk më duket mirë qi të rrimë lark edhe mësueset, të cilat, me përfundim të pëlqyeshëm, mund të shkruiejnë thema mbi qeverrim shtëpiak, punë-dore etj.. qi përmbanë programi shkolluer për vajzat.

Ku janë mësuesët Normalistë ? . . Duhet të bashkëpunojnë me vllëznit e ’tyne më të vegjël e të mos kujtojnë se, me mbarimin e shkollës, mbāroi edhe detyra e ’tyne shoqnore! S’duhet të harrojnë bangat, ku rrijshin më parë, pse po n’ato po rrijnë edhe shokët e ’tyre, qi po e gatuejnë kët brum!

Kur janë edhe ata, qi e kanë fitue praktikën e mësuesis, se jam në gjendje me u sigurue mirësin qi kanë me bāmë, po të ndihmojnë nxânësit e ’tyre! Atëhere kanë me e përmbushë më mirë shërbimin dhe vetëm at’here do të kenë të drejtë me u-mburrë se kanë krye një detyrë! Kritikat dhe shkrimet e ’tyne janë të vlershme e me vend tash, dhe praktika e plotson detyrën e ’saj.

Mbi të gjitha këto, qëllimi i im është qi, sh’ka janë mësues, të rrahin mendimet e ’tyne në këte të përmuejshme pedago-

gjike, tue u-kallzue edhe sistemet e methudhat e ndryshme të mësimit, qi kështu të mundet me u-zgjedhë ajo më e përshtatshmjia e më përfundimtarja për vendin e ambjentin t'onë.

— Ta ndihmojnë pra "Normalisti-n., e të bashkëpunojmë ke ky, për hirë të detyrës qi na është ngarkue, pse edhe kjo është një mënyrë për me i arritë qëllimit t'onë kryesore, qi nuk është t'jetër, veç ideali i përbashkët për të mirën arsimore.—

Musa E. Tafa

Shënim:— Disa periudha të këtij shkrimi janë botue edhe në numrin 6, viti i VI, 1935. Arsyeya është se, një kopje të këtij, ia pata dërgue "Normalisti-t., për botim, qysh vitin e kaluem. Mirpo, mbasi do të prites dalja e kësaj së përkohëshmes, editori i atëhershëm ka marrë nga ky shkrim, aty-këtu, disa fjali dhe ia ka veshë kryeartikullit të këtij numri, me titullin: "Pajtimtarë të "Normalistit.,

Ky është shkakui qi shifen të përsërituna për së dyti.—

Shënim : Më 22 të Dhjetorit, nga fryrja e madhe e Shkumbinit, u këput ura gjiganteske prej 200 e ca metro për habi të të gjithëve. Mbi urë ndodheshin atë minutë 4 **shokë** t' anë dy prej të cilëve ranë viktim t' asaj katastrofe. Dy prej tyre, çuditërisht, shpëtuan. Një nga të shpëtuarit, që të kënaqi kuriozitetin e këndonjësvet, përshkroi ngjarjen tragjike, që më poshtë botohet :

Në dallgët e Shkumbinit.

Këtu poshtë, o këndonjës i dashur, po të kallëzoj katastrofën e madhe që më ngjau :

Ishte dita e Diel e 22 Dhjetorit të vitit 1935, ajo ditë fatlume që linda edhe një herë.

Ora 3.30, i unjur përmbi një fron në oborin e shtëpisë s' ime këndonja një libër, kur, një trokitje e lehtë bie në portë; ngrihem e hap, ishte Murati (një ndër të dy viktimat e lumit), i cili më përshëndeti me nënëqeshjen e tij të gëzuar. I thashë të vinte brënda, por nuk kishte qejf. — Hajde të vemi nga Shkumbini — më tha me zërin e tij të embël — Me të vërtetë për të shkuar është, — i thashë — ka dalë mjaft, unë jësja edhe në mëngjes e e pashë, por vemi më von, eja tani të pimë nga një kafe. — Ishin të kota fjalët e mia, me asnjë mënyrë nuk deshi të hynte brënda; ahëre vësja kapotën e madhe, dhe të dy bashkë muarmë drejtimin e urës së Shkumbinit, nuk kishim ecur më shumë se 20-25 m. kur disa zëra na thësin : — Hysejn, Murat, pritnani edhe neve. Kthym kryet, ishte Xhaviti (edhe ky

viktim tjetër) me Rustemin, të cilët ishin drejtuar edhe ata për në Shkumbin. U-shoqëruam të katër bashkë; ecnim me hapa të shpejta e të lehta gjersa mbritëm në urën e Shkumbinit Po ç' të shohim! Lumë a po det? Ishte me të vërtetë për t' u çuditur! Shkumbini kishte dalë mjaft dhe shumë më tepër se kurdoherë, nga shkaku i shirave të vazhdueshme; kishte mbuluar të gjithë zallin, kishte kapërxyer murin mbrojtës dhe kishte mbuluar rrugën që shkon për në Llixha Dallgët me një rrëmbim të math kalonin njera pas tjetrës duke u hedhur 2-3 m. lart sipër së ujit; sillnin gjithë farë soj bimësh të mbëdha, aq sa gjithë populli që ndodhej aty, dhe që kishte ardhur posaçërisht të shihte lumin, thoshte : — Po vjen vapori, erdhi vapori, etj . —

Si ecnim nga pak metra, ndaleshim në hekurat e urës dhe shikonim valat e rrepta që ecnin me rrëmbim; duke ecur në këtë mënyrë, harritëm në dy këmbat e fundit ku u ndalëm. Këtu dallgat ishin më të fuqishme se në çdo vënt tjetër; këtu lum; nuk shteron kurrë. Të mbështetur përmbi hekurat dhe të khtyer nga ana e Jugës shikonim me kujdes dallgët e fryera që kalonin me vrull të math dhe prej forcës së madhe që përpiqeshin njera me tjetrën e përplaseshin në mur, ngriheshin në një lartësi prej pakë metrash. Dukej sikur do të të përpinin të gjallë ato vala, që të tmeronin kur i shikoje! të ngjethnin trupin! të trubullonin mëndjen!, me gjith' atë neve me një gjak ftohtësi rinim, të katër krah për krah, përmbi 'to dhe i shikonim.

Midis shumë fjalëve të tjera që këmbuem në mes t' onë Rustemi thotë : — Sikur të këputet ura dhe të të biem në mes t' atyre dallgëve!! . . . — Plaç të preftë — ja prita unë — pse flet kështu ters! ? — Sikur është gjë, nga goja t' ime — thotë prapë — Nuk të them se është nga goja t' ende — i thashë — po përse të flasësh kështu ters!!

Me mbarimin e këtyre fjalëve, nuk di në ç' mënyrë t' a tregoj! nuk gjej fjalë qysh t' a shpreh rëzimin e urës! nuk na dha as shënjëni më të vogël të kupëtonim se po binte gjith' ajo urë madhështore!! M' u duk sikur të ishte një lëkundje tërmeti, rashë së mbrapmi dhe prita që të më përpiqeshin kryet në shtresën e tokës s' urës, por më kot! Befas u përzejva me gurët, me zhurin e me rërën q' ishte ngrehur ura, dhe bashkë me këto u fundosa në funt të lumit!!! Rashë përmes dallgëve!! , Shokët nuk i pashë më!, As not nuk dija që të kisha ndonjë shpresë,

por me gjith' atë, nga dhëmpshuria e jetës, bera disa lëvizje, por më kot! Dallgët më nxirnin sipër ujit, por prapë, pa farë mëshirë, më përpinin të gjallë! E humba çdo shpresë!! S'kisha më shpëtim!! Mbulova fytyrën me durtë që më dridheshin si purteka dhe thoshe me vehte: — Këndej . . . e kisha . . . kader . . . ; të vdisja . . . nga . . . lumi . . . i Shkumbinit . . . dhe mbas disa sekondave prapë thashë: — Po kur . . . të mësojnë . . . nga shtëpia . . . vallë . . . ç' do të . . . bëjnë? . . . kaqe . . . dhe u bashkova me fatin e lumit! — Po Z. i math pati mëshirë për mua! Kalova mjaft sekonda duke lëftuar me dallgët, gjersa një valë tjetër e mëshirshme më kreu n'anën e tejme të Shkumbinit — A jam në ëndër?! — thashë me nga dal — Jam akoma i gjallë?! Nuk e besoja! Kur sytë më panë qiell e tokë, s' di qysh të them: s' di qysh t'a kallëzoj! Gjuha njerzore është shumë e vobegjë dhe s' munt t'i shprehij dot të gjitha mendimet e njeriut; dhe sidomos në raste të tilla. Nuk munt të rija më në këtë gjëndje, po hodha sytë reth e rotull për të kërkuar ndonjë ndihmë!. Mjaft u-çudita, kur pashë Rustemin 3-4 m. larg meje, fytyra e të cilit ishte e mbuluar me gjak, larg neve ishin shumë njerës, disa prej të cilëvevet i njoha dhe me një gjysmë zë ju fola n'emër: — Elmas, . . . Hamit! Ejani shpëtonani! Amani more! . . . — . . . Nuk e shihni se po mbytemi? . . . I flitja pa pushim Rustemit, dhe ky më fliste mua, Asnjë ndihmë nuk na erdhi përpara! Kishin dhe të drejtë! Kush hynte në gojën e kuçedrës së egërsuar? Kush rezikonte kryet e veta për shpëtimin t'onë? Në vëndin që ishim neve, vërtet nuk kishte shumë ujë, por për të ardhur gjer atje duhej të kalonin në rrymë të thellë dhe të rrëmbyeshme; këjo i ndalonte njerzit të hidbeshin atje, për këtë, sillëshin posht' e përpjetë që të gjenin ndonjë va, por më kot! Neve nuk na rihej më në atë vënt, se na dukej sikur do të vinte ndonjë dallgë tjetër të na rrëmbente, prandaj të dredhur, të trubulluar dhe gjysmë të vdekur shkuam n'anën e rrymës; atje na hodhën litarin, u kapëm prej 'tij dhe me zi duallmë n'anën tjetër që të dy; pa dashur nxora një sasi uji që më kishte hyjë brënda.

Na morën të dyve për krahu dhe na shpunë në një kasolle që ishte aty afër; mere me mënt o këndonjës i dashur, në ç'gjëndje të frikëshme ndodheshim!!! Nuk deshi Zoti që të vdisnim, se u ndodhën aty afër disa burra bujarë, të cilët

mbluadhnë reth e përqark disa dru, me të cilat na bënë një zjarr të math, thajtëm robet një e nga një për tërë natën dhe, me mzi e gdhijtëm atë natë të frikëshme . . . atë natë t' errët e të tmerëshme që na u duk e gjatë sa një muaj . . . Përkrahasit t' onë që ishin me neve na pyetnin herë mbas here për shëndetin. Në kasollen ku rinim, me gjithë se kishim hallin e kokës t' onë, prapë mëndja na shkonte tek të dy shokët e tjerë, me të cilët ishim shoqëruar dhe thoshnim: — Po Murati me Xhavitin ku janë, ku ndodhen? . . . Mos vallë i ka kryer edhe ato vala më ndonjë anë? . . . etj. . .

Me t' aguar dita, miqtë e natës dollën jashtë kasolles dhe mbas pake neve; lumi ishte pakësuar mjaft; në këtë kohë, një bujk, që mblithte dru, aty afër bërtet: — Ja një nga të mbyturit! — Të gjithë shkuan atje ku u gjet kufoma, veç unë dhe Rustemi, përse nuk kishim zëmër të shihnim shokun t' onë; mbas shënjavet që na dhanë, kupëtuam se ishte Xhaviti. aty që qëndronte gjithëmonë i qeshur e i gëzuar; i shkreti Xhavid i mjeri djalë! (Murati nuk u gjet më ndonjë vënt aty afër, veç mbas dy ditëve në një vënt të largët). Autoritetet, që ndodheshin nga ana tjetër e lumit, na lajmëruan të niseshim sa më shpejt për në Uren e Kamares.

U-nisëm n' orën 8,30 të mëngjezit dhe më orën 9 para mes nate harritëm në vëndin e më sipër.

Nuk qenë mjaft ato që hoqëm se fati na kish dënuar të ecnim edhe 13 orë pa pushuar midis atyre pyjeve, prenjve e shkëmbenjve aq të rezikshëm gjer sa mbritëm në Uren e Kamares. Kaluam natën në shtëpin e ca njerzve fisnikë e bujarë dhe të nesërmen, të gjithë sa ishim, erdhëm me automobil këtu në Elbasan.

Këjo, pra, qe me pakë fjalë, historia ime e çuditshëme. —

Hysejn Hashorva

Elbasan, më 15-Janar-936

Të reja pedagogjike.

Ministria e Arsimit e Polonisë po bân gati programat e çkoqituna të tipavet të ndryshme të shkollavet. U-botuen deri ndashti në fletë të veçanta projektet e programavet të periudhës së parë e të dytë të shkollavet fillore; shoqënit' e mësuesvet, specialistët e theorisë s'edukatës, inspektorët, këshillat shkollore

kanë për të shqyrtue e për të vëzhgue këta projekte, për me marrë mbasandaj formën e fundit. Janë tue punue n'atë Ministri edhe mbi programat e shkollavet të tjera. Përmbi 500 arsimtarë kanë marrë pjesë n'elaborimin e këtyne programave.

✽

Për vjetin 1935-1936 Ministrija e Arsimit e Italisë ka me çelë 1200 shkolla fillore të reja, nga të cilat 200 janë shkolla katundesh.

✽

Kongresi ndërkomtar pedagogjik, që u-mbajt në Bruksel prej 25 të Korrikut deri më 4 të Gushtit të kaluem e për të cilin shkruen të Numri i 6 "Normalistit", të Qershorit që shkoi, ka pasë një të qëlluem të math fort. Muerë pjesë 700 antarë kombësije të ndryshme Kongresi i afërm ndërkomtar pedagogjik ka me u-mbajtë më 1937 në Paris në rasë t'Ekspozitës së përbotshme. Në Kongresin e pestë ndërkomtar t'Edukatës familiare, që u mbajt prapë në Bruksel prej 31 të Korrikut deri më 4 të Gushtit e për të cilin u fol po tek ai numër i "Normalistit", muerën pjesë 500 kongresistë t'ardhun prej 40 visesh të ndryshme të botës, andyç edhe prej Bullgarisë.

✽

Përmbi 70 studentë bullgarë të sgjedhun prej Ministris s'Arsimit të Bullgarisë vojten nëpër shkollat e nalta bujqësore të Danimarkës, ku kaluen 18 muej, për të studjue praktikën e bujqësisë. Të kthyem në Bullgari studentët bullgarë çfaqën kënaqsin'e çuditjen e tyne për përparimin bujqësuer të Danimarkës, ku mundën me fitue njohni me randësi mbi kooperativat e ndryshme të vendit, mbi higjienën e mbi mënyrën e jetesës së Danimarkasvet.

✽

Në Prendverë të vjetit 1936 ka për t'u-mbajtë n'Athinë i pari Kongres ballkanik i mprojtjes së fëmijvet.. Kongresi është organizue prej Bashkimit ndërkomtar të ndihmës fëminore dhe të veprës patriotike greke për mprojtjen e fëmisë.

Shënim: — Këtë faqe e kemi dedikuar nxanësve të Qytetses Herë pas here këta mund të shkruajnë hartime, përshkrime vjersha etj. ma të mirat e të cilavet do të botohen në këtë faqe.

Fëmija pa mëmë si nata pa hënë.

Nji fëmijë që s'ka mëmën e vet është shumë i mjerë, është shumë fat keq. Po pse? se mëma është ajo që kujdesohet me

gjithë shpirt për fëmijën e saj. Mëma humbet jetën e saj për fëmijën e vet, sepse ajo që kur jemi foshje mundohet dhe prish gjumin e saj për të mos mërzitur fëmijën, mundohet që t'i rritij me vetija të mira që të bëhet një ditë i lumtur dhe fat bardhë.

Ja një ngjarje me anë të së cilës kuptohet haptas dobjia e mëmës.

Ishte një herë një at dhe një mëmë të cilët kishin dhe një djalë të vetëm. Këta rronin shumë të lumtur.

Mbi të mirë e sipër e zunë një ditë ethe të rënda mëmën dhe sa do qi i bënë me doktorë e me barëra nuk gjeti shërim, se dobësohej më keq. Djali i shkretë qante mbi kryet e mëmës dhe i përmbushte dëshirat e saj, por më kot se ajo dal nga dal po keqësohej e fuqija i pakësohej; si e pa që nuk kishte shp-tim, në minutat e fundit thirri të birin e saj dhe i tha: "eja të të puth për herën e fundit se po vdes e po të lë; ti vazhdo me këto sjellje të mira që ke patur gjer tashti se Zotit të math do t' i vijë keq dhe do të të ruajë. Atij lutju gjithmonë të të mbushë dëshirat.", Me mbarimin e këtyre fjalëvevet ora e zezë afëroj dhe e ndau nga i dashuri djalë.

Babai i tij pruri në shtëpi një njerë bashkë me dy djem. Me të hyrë e njerka në shtëpi djali hiqte shumë keq prej saj. Shumë herë i shkreti djalë mbetesh pa ngrënë dhe vishesh me recka. Me një fjalë njerka s'përkujdesesh fare për të, po vetëm për djemt e saj.

Në këtë rast i shkreti djalë mendonte mëmën dhe një fjalë të moçme që thotë: fëmija pa mëmë si nata pa hënë.

Pas shumë të këqijave që vuante prej njerks, zotit të math i erdhi keq dhe ja ku na del një njeri që s'kishte fëmijë, e mori e rriti si djalin e tij, atje kaloi një jetë të lumtur e fat bardhë. Kështu që u sosën të këqijat e djalit e u hoq nga duart e njerks. Nga kjo kuptohet që mëma është më e vjefshme në botë prandaj duhet t'a duam me shpirt e të mos e mërzitim në as një pikë po përkundrazi t'a kënaqim e t'i mbushim gjithë dëshirat.

Ervehe Kallajxhi

Kl. e III të e qytetëses

Elbasan, më 20 Janar 1936

Lajmet e shkollës.

— Kanë urdhëruar në shkollën t' onë sivjet dy profesorë të rinj: z. Jan Shuteriqi, i gjuhës Italishte dhe z. Isuf Luzaj i gjuhës Frëngjishte.

— Para disa ditësh u-largua prej nesh profesori i linguishtikës z. Dr. Namik Resuli. Zotnija e tij u transferua për në Gjimnazin Shtetnor të Shkodrës po me ate detyrë.

— Më 22 të këtij Muaji profesor' i vizatimit z. Zef Kolombi celebroi martesën me Zonjushën Liria Papamihali mësuese n' Elbasan. "Normalisti", uron çiftit të ri jetë të lumtur dhe fat-bardhë.

— Klasa e VI e shkollës s' onë vendosi të mbajë një seri konferencash. Këto do të mbahen prej nxënësve, mbi thema të ndryshme, një për çdo javë. Po të mirën me seriozitet do të jenë mjaft të dobishme. Mendim i bukur. Inisiatorve "Normalisti", u shtrengon dorën.

— Një lëvizje e madhe sportive shihet në shkollën t' onë. Ndërmjet garave të ndryshme qi janë zhvilluar esht per t' u shenuar ajo e vrapimit Elbasan — Qafë e Krabës, ku muarën pjesë më se 70 konkurenta. Aktivitet sportiv i detyrohet instruktorve t' Edukatës Fizike të Shkollës s' onë; z. z. Pjeter Andoni dhe Alush Lleshanaku që punojnë pa reshtur.

Posta e jonë :

Z. Z. B. Çela, S. Alliu, J. Kuvarati, S. Murati, M. Tafa, S. Spasse, H. Ballshi, S. Caci. M. Golemi etj. Presim shkrime.

Një pjesë nga shkrimet qi na janë dërguar nuk u botuan me këte numer nga mungesa e vendit.

V. R. Numëri i dytë do të dalë pikërisht më 28 të Shkurtit me lëndë më të shumtë dhe më të zgjedhur. Janë të lutur Z. Z. bashkëpunorët të dërgojnë shkrimet e tyre sa më parë që të mundim të rregullojmë lëndën me kohë.